



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Pranuar / Dorezuar Prijmjeno/Prilato Received/Delivered	14. 01 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Hr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHU	148/2021		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.394/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 394/2020 të datës 04.12.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr " Vëllezërit Gërvalla ", Nr. 3/6, Bregu i Diellit, Komuna e Prishtinës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Kryeministrit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/mos vazhdim i kontratës së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 14.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.394/2020 e datës 04.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 04.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2954/2020 të regjistruar me numër A.nr.394/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, për vazhdimin e mandatit të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 15.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati Koordinues i Qeverisë. Ndërsa më datë 08.01.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 394/2020, e datës 04.12.2020, me numër protokoli 2954/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesën e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës të datës 23.07.2020 drejtuar Sekretariatit Koordinues të Qeverisë; Përgjigje në ankesën përmes e-mailit të datës 08.01.2021 me numër protokoll 33/2021 ; Raporti i Vet-Vlerësimit i datës 08.08.2020 nga L.N për N. T, Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje të Trupave Qeveritare ; Raport Vjetor i Vlerësimit për vitin 2019-2020 i datës 07.07.2020 nga L.N për N. T, Udhëheqës i Divizionit për Mbështetje të Trupave Qeveritare; Vërtetim për pranimin e kërkesës i datës 02.12.202; dhe Vendimi nr.10/150 i datës 21.07.2017.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pa lejuar sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit Nr.10/150 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 21.07.2017 është emëruar në pozitën e Drejtorit të Autoritetit të Kualifikimeve, në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me mandat tre (3) vjeçar. Emërimi i ankuesit në pozitën e Drejtorit të Autoritetit të Kualifikimeve, është bërë sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.


Pas përfundimit të mandatit të ankuesit sipas Vendimit Nr.10/150 të datës 21.07.2017, Ministri i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, me datë 23.07.2023 përmes parashtrësës me nr. Protokoll 1681, i është drejtuar Këshillit për Emërime në Pozitat e Nivelit të Lartë Drejtues, më kërkesë që ti vazhdohet kontrata Drejtorit të Autoritetit të Kualifikimeve, e ne rastin konkret ankuesit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është mohuar e drejta për trajtim të barabartë respektivisht e drejta për ri zgjatjen e mandatit si Drejtori i Autoritetit të Kualifikimeve ashtu siç përcaktohet me nenin 42 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ;* 2. *Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht në kërkesën e datës 23.07.2020, të Ministrit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për zgjatje të mandatit të ankuesit në pozitën e Drejtorit të Autoritetit të Kualifikimeve, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 04.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.394/2020

Clirim Zeka



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-Demi



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Zyrës së Kryeministrit të Republikë së Kosovës
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Ministrit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
- Arkivit të KPMSHCK-së.

